



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Shk II.nr.1344/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Nderimi&IEN”, Sh.p.k, me nr. unik identifikues 8107766073 me seli në Podujevë me adresë rr. “Fitorja” kundër debitorit “I&B-Group”, Sh.p.k me numër unik identifikues 810142430 me seli në Prishtinë me adresë K.D.Q Tregtare nr.48, i cili sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat A.K. me zyre në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2265/22 të datës 18.08.2023, me datë **05.03.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e kreditorit “Nderimi&IEN”, Sh.p.k, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2265/22 të datës 18.08.2023, **PRISHET** dhe çështja i kthehet Gjykatës Komerciale, dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale Dhomat e Shkallës së Parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.2265/22 të datës 18.08.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar prapësimin e debitorit “I&B-Group”, Sh.p.k, si të bazuar, ashtu që është anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr.471/21 i datës 17.11.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Shala.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2265/22 të datës 18.08.2023 apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje

Kreditori nëpërmjet përgjigjes në ankesë ka theksuar se fatura në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbartimore nuk i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 29 par.1 dhe 3 të LPP-së për të qenë dokument i besueshëm sepse nuk përmban saktë objektin e detyrimit në emër të cilit kërkohet realizimi i borxhit. Andaj, Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur drejt arsyetimin e vendimit të saj.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- **Ankesa e kreditorit është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të në bazë të dokumentit - faturë nr.2021/112 e datës 02.09.2021, duke detyruar debitorin që në emër të borxhit nga fatura e lartcekur t'ia paguaj kreditorit shumën e përgjithshme prej 4,674.89€ (katërmijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër euro e tetëdhjetë e nëntë cent) dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen nga momenti i dorëzimit të propozimit.

Kundër këtij urdhri debitori ka paraqitur prapësim duke theksuar se fatura nr.2021/112 e datës 02.09.2021, është dashur të jetë e nënshkruar dhe vulosur nga debitori është dashur të vërtetohet se kujt i dorëzohet malli, kush është personi që i dorëzohet në rastin konkret, andaj fatura në bazë të cilës është iniciuar procedura përmbartimore nuk përmbush kushtet bazike për të qenë e ekzekutueshme pasi që e njëjta nuk i është pranuar asnjëherë nga debitori. Andaj gjykatës i ka propozuar që të pranohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet Urdhri për lejimin e përmbartimit. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit për faktin se propozimi për përmbartim është paraqitur konform dispozitave ligjore në bazë të nenit 29 të LPP-sepse është në origjinal, andaj debitori ka qëllim të prolongoj procedurën. Me kërkesë që të refuzohet prapësimi i debitorit si i bazuar ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin dhe përgjigjes në prapësim ka aprovuar prapësimin e debitorit "I&B-Group", Sh.p.k, si të bazuar, ashtu që është anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr.471/21 i datës 17.11.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Shala.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka vlerësuar se fatura nr.2021/112 e datës 02.09.2021 nuk është e përshtatshme për përmbartim dhe nuk përmban tipare të përmbartueshmërisë, pasi që e njëjta nuk përmban në mënyrë të saktë objektin e detyrimit në emër të të cilit kërkohet realizimi i borxhit prej 4674.80 EUR.

Deri tek ky vlerësim gjykata e shkallës së parë, erdhi pasi që në rastin konkret, fatura objekt i këtij përmbartimi është lëshuar në vlerë prej 7,034.69 EUR në emër të 3726 njësive "lamarinë e plastifikuar e përpunuar" por që nga vet deklarimet e kreditorit në përgjigje në prapësim, i njëjti ka theksuar se ka furnizuar me material debitorin vetëm në vlerë prej 4674.80 EUR, andaj ka kërkuar vetëm vlerën e pjesshme nga shuma totale e faturës, mirëpo nuk dihet saktë si ka ardhur deri tek shuma e kërkuar me propozim, konkretisht në emër të cilit detyrim konkret (njësive) është

kërkuar ky borxh. Mbi këtë bazë, Gjykata konsideron se dokumenti mbi bazën e të cilit lejohet përbarimi nuk mund të ketë tipare të pjesshme të përbarueshmërisë ashtu që palës kreditore t'i mundësohet realizimi i pjesshëm i borxhit nga dokumenti i besueshëm, përderisa vet kreditori nuk i është përmbajtur detyrimit të tij në tërësi për furnizim me material sipas faturës nr. 2021/112 e datës 02.09.2021.

Gjykata Komerciale vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 183 dhe 184 të LPK-së, lidhur me nenin 21 dhe 29 par.3 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë me aktvendimin KPPP.nr.2265/22 të datës 18.08.2023 me të cilin ka aprovuar prapësimin nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë pasi që nuk ka vërtetuar se dokumenti besueshëm- fatura a i plotëson kushtet sipas ligjit për të qenë dokument i besueshëm, pasi që e njëjta eshë pranuar dhe nënshkruar nga debitori. Sipas dispozitës së nenit 29, paragrafi 3 të LPP-së, përcaktohet se: “Dokumentet i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”, e po ashtu me Udhëzimin Administrativ Nr.15/2010, për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, përkatësisht në nenin 20, paragrafi 1.1.17, përcaktohet se: “ në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore”, andaj në rastin konkret gjykata pa të drejtë ka vlerësuar se fatura në bazë të cilës është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm. Është i paqëndrueshëm vlerësimi i shkallës së parë se fatura nuk përmban qartë objektin e detyrimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se propozimi për përbarim është iniciuar në bazë të faturës nr.2021/112 e datës 02.09.2021 e lëshuar në shumën prej 7,034.69 EUR e nënshkruar dhe pranuar nga debitori ku objekt detyrimi ka qenë “llamarinë e plastifikuar e përpunuar” ndërsa kreditori nga kjo faturë ne propozimin për përbarim ka kërkuar vetëm shumën e mbetur prej 4674.80 EUR. Fakti se kreditori në përgjigjën në prapësim ka deklaruar për gjykatën se i njëjti ka furnizuar me material debitorin vetëm në vlerë prej 4674.80 EUR, për çka ka kërkuar vetëm vlerën e pjesshme nga shuma totale e faturës, për gjykatën është e qartë se nuk ka kërkuar borxhin në tërësi pasi që ka kërkuar aq sa i ka dërguar material debitorit.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se objekti i detyrimit është përcaktuar në faturë “llamarinë e plastifikuar e përpunuar” andaj edhe në bazë të së njëjtës është kërkuar shuma e borxhit në mënyrë të pjesshme.

Gjykata Komerciale – dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se në këtë rast nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të aprovuar prapësimin e debitorit prandaj, ankesën e kreditorit e

pranoi si të themeltë dhe çështjen vendosi t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike të vlerësojë dokumentin përmbartimor, se a i plotëson kushtet nga neni 29 par 3 të LPP-së, eventualisht të hapë edhe seancë për ti vërtetuar pretendimet e palëve në këtë çështje përmbartimore, e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1344/23, me datë 05.03.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami